



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

Datë :	05.09.2016
Referencë	11-344/8
Për :	Kryetar i Komunes-z. Imri Ahmeti
Përmes :	Drejtpërsëdrejti
Nga :	Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - Imer Rrustemi
Lënda :	RAPORTI MUJOR-GUSHT



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



Pasqyra tabelare e punës për muajin –GUSHT

Inspektorët	Gjithsej	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Inspektime për pirjen e duhanit	Vërejtje, njoftime	Inspektime për orar të punës	Lëndë e ekzekutuara gjyqësore	Inspektime të përbashkëta	Pelqim sanitar	Inspektim i auto-taxi	Menaxhim i tregjeve dhe inspektim i biletave	Aktivendime- ndalesa, urdhëresa	Kërkesa, pune me palë	Mbyllje e përkohshme e lokalit afarist	Inspektim i kafshëve në thertore	Inspektime me polici	Inspektim për farëra, plehra, pesticide si dhe tokav bujqësore	Asgjësimit i mallit	Biznese të pajisur me, pa pranime teknike, per çmime	
Biznesit	591	55	16			74			60			13	89	222	1		10		2302.00	51	
Ambientit	311	51				5			125					121			9				
Bujqësisë	257	20				42			59					83				53			
Ndërtimtarisë	165	27							95				1	42							
Trafikut	322	22		2		57			36		93	10		43			59				
Sanitar	284	41			50	32			103	1				22		35			2302.00		
Gjithsejtë	1930	216	16	2	50	210			478	1	93	23	90	533	1	35	78	53	2302.00	51	

DREJTORATI I INSPEKTORATIT

Gjatë këtij muaji kemi punuar rreth identifikimit të bizneseve të pa regjistruara MTI, dhe pa pranime teknike të lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko higjieno sanitare, kemi kontrolluar maketet ushqimore, dhe biznese te tjera që operojnë nëpër qytet dhe fshatra të Komunës së Lipjanit, bizneset rreth aftashmerisë së mallit, kushtet e ruajtjes së mallit, librat e punës, faturat e furnizimit me mall, dhënien e faturave për shërbimet e ofruara konsumatorëve, çmimet e vendosura në artikuj, kalibrimin e peshoreve etj.

Aksion i veçant inspektimi mbi prejardhjen e mishit, kështu që gjatë muajit janë inspektuar të gjitha mishtoret si dhe marketet dhe gjatë inspektimit kam asgjësuar 635 kg Mish.Po ashtu në nje market kam asgjësuar edhe 700 kg ushqim me afat të skaduar si dhe mall i demtuar. Në njërin prej marketeve kam asgjësuar “ shmand “, i cili ishte i pa përshtatshëm për konsum në vlerë prej 82.8 € apo në pesh prej 57.6kg, po ashtu në një furr të bukës kam asgjësuar produkte (Jogurt dhe Ajran) në vlerë prej 19.5 €. Gjatë muajit së bashku me Inspektorët e AUV-it kemi asgjësuar tri kafshë të ngordhura nga LSD (Sëmundja Gungore e Lëkurës),të cilat kafshë kan ngordhur në fsh.Brus, po ashtu kemi inspektuar edhe disa kafshë të tjera të sëmura me këtë sëmundje.

Gjate këtij muaji janë inspektuar te gjitha lokalet qe shfrytëzojnë hapësirën publike, te cilat me shkrim janë urdhëruar qe te pajisen me dokumentin përkatës qe lejon shfrytëzimin e kësaj pjese.

Janë inspektuar disa kafiteri në qytet në orët e mbrëmjes në lidhje me zhurmën, këto biznese janë urdhëruar që ta ulin nivelin e muzikës, dhe ajo të mbahet në suaza normale me qellim që mos të pengohet banorët për rreth.

Janë inspektuar disa fshatra dhe ne qytetin e Lipjanit,ku inspektimet janë bere ne baze te kërkesës se palëve dhe planit tone. Kërkesat kryesisht kishin te bëjnë me ujerat e zeza, zhurmën dhe mbeturinat.

Janë inspektuar doponite ilegale të mbeturinave në qytet dhe fshatra, dhe është inspektuar ambienti ne përgjithësi.

Gjatë muajit Gusht kemi bërë inspektim të vazhdueshëm në Airoportin Ndërkombëtar “ **Adem Jashari** “ në Vrellë ku kemi organizuar aksion në bashkëpunim me Policin kufitare të **Airoportit** në lidhje me disa auto-taksi të cilët po tëntojnë të ushtrojnë veprimtari ilegale, pra për ata të cilët i kemi hasur duke ushtruar veprimtari ilegale janë marr masat ndëshkimore në bazë të Ligjit. Po ashtu është bërë inspektimi në rrugën “ Lidhja e Prizrenit “ku janë inspektuar auto-taksit të cilët janë vendosur në këtë rrugë .

Po ashtu gjatë keti muajit janë inspektuar- kontrolluar edhe kompanitë e autobusëve të cilat operojnë në Komunën e Lipjanit në lidhje me rendin e udhëtimit se janë duke e respektuar dhe është bërë kontrollimi për Licensë.

Gjatë këtij muaji kam inspektuar Tokat Bujqësore ku janë demtuar nga hedhja e masave të dheut, mbaturinat dhe ujrat e zeza, kam inspektuar shitsit e drunjëve për posedimin e letrave përcjellse si dhe kam liruar disa parkime ilegale të shitësve.

Gjithashtu kam kryer disa inspektim-vlersime mbi dëmet e shkaktuara nga reshjet atmosferike te disa kultura bujqësore me kërkesë të fermerve.

Gjatë këtij muaji janë inspektuar objektet në vendpunishte nëpër qytet si objekte me leje ndertimore ku është përcjellë faza e punimeve ndersa për objektet tjera janë marr masa konform ligjit te ndertimit per ndalim te punimeve ilegale të cilat objekte janë duke u përcjellur vazhdimisht se mos janë duke vazhduar punimet.

Vlenë të cekët se ne inspektorët e ndertimit jemi duke i kontrolluar të gjitha objektet ndertimore te cilat kanë tentuar të punojn pa Leje Ndërtimore dhe të cilët janë nën kontroll në qdo kohë si dhe gjatë ditëve të vikendit.

Të dhënat statistikore janë të paraqitura në tabelë.

